



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 10733 Prot.

Lezhë, më 03.06. 2021

V E N D I M

Nr 101, Datë 28 / 05 / 2021

PËR

MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KRYESISË SË FSHATIT TRESH, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN, BASHKIA LEZHË, PËR SHKAK TË NDARJES NGA JETA TË ANËTARIT TË ZGJEDHUR TË LAGJES MANATI (FILDANË)

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 8, neni 53, neni 54 dhe neni 70, pika 4, me propozim të Kryesisë së KB Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Miratimin e fillimit të procedurave për zgjedhjen e anëtarit të kryesisë së fshatit Tresh, Njësia Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë, në lagjen Manati (Fildanë), për shkak të ndarjes nga jeta të anëtarit të zgjedhur të kësaj lagjeje, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
2. Bazuar në VKB nr. 113, datë 26.08.2020 dhe VKB nr. 138, datë 14.10.2020, të deleguarit do jenë këshilltarët:
 - I. Artan Ndreu
 - II. Ndue Luli
 - III. Rinev Danaj
 - IV. Edlir Reçi
 - V. Ernest Rakaj
3. Ngarkohet Këshilli Bashkiak për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

